



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 108 dt.29.07.1996

**PER**  
**DHENIEN E NJE FONDI PER LIKUIDIMIN (PRIVATIZIMIN) E**  
**NDERMARRJES PRODHIMEVE ARTIZANATIT NR.2 TIRANE**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.07.1996, pasi shqyrtoi “Relacionin për dhënie e një fondi për likuidimin (privatizimin) e Ndërmarrjes Prodhimeve të Artizanatit Nr.2 Tiranë”, mbështetur në vendimin Nr.589, dt.16.10.1995, pika.7, të Këshillit të Ministrave,

**VENDOSI**

1. Ndërmarrjes së Prodhimeve të Artizanatit Nr.2 Tiranë, ti jepet një fond page, për likuidimin e saj.
2. Fondi i dhënë të jetë në kontroll të Drejtorisë së Administrimit Financiar dhe Seksionit të Prognozës.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Administrimit Financiar dhe Seksioni i Financës.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**